

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE

STATUT-RREGULLORE
E FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË
KOMBËTARE TË BURIMEVE
NATYRORE (AKBN)

AZHORNUAR NË KORRIK 2018

Në zbatim të pikës 7, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 09.08.2006, formulohet Statut-Rregullorja e Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN).

Neni 1

Statusi Juridik i AKBN

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, më poshtë AKBN, është person juridik, ent publik, në varësi të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Neni 2

Selia

Selia e AKBN do të jetë në Tiranë, në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”.

Neni 3

Vula Zyrtare dhe Stema

AKBN ka vulën dhe logon e saj, të miratuar nga Ministri.

Neni 4#

Financimi

“Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, nuk financohet nga Buxheti i Shtetit. Megjithatë, agjencia ka të drejtë të përfitojë projekte të financuara nga buxheti i shtetit apo subjekte të tjera.

Për shërbimet që ofron, siguron të ardhura në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë e saj.

Buxheti i agjencisë miratohet nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Neni 5

Fusha dhe Objekti i Veprimtarisë

AKBN e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e AKBN”, të ndryshuar për krijimin e saj dhe sipas Statut-Rregullores.

Neni 6 #

Objekti i Statut-Rregullores

“Statut-Rregullorja përcakton funksionimin, strukturën organizative, strukturën e pagave të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, e cila miratohet me urdhër të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë”.

Neni 7

Organet Drejtuese

1. Këshilli Drejtues
2. Drejtori Ekzekutiv
3. Zv/ Drejtori Ekzekutiv

Neni 8

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organ kolegjal vendim-marrës, për mbikëqyrjen e funksionimit dhe veprimtarisë së AKBN.
2. Këshilli Drejtues përbëhet nga 7 anëtarë dhe kryesohet nga Kryetari i saj.
3. Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen dhe lirohen nga Ministri.
4. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues, caktohet sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 9

Funksionimi i Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues zhvillon mbledhjet, si rregull, në vendin, ku ka selinë Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.
2. Këshilli Drejtues zhvillon veprimtarinë, nëpërmjet mbledhjeve të anëtarëve të tij dhe marrjes së vendimeve. Mbledhjet quhen të vlefshme kur në to, marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve të tij.
3. Mbledhjet e Këshillit Drejtues zhvillohen jo më pak se një herë në tre muaj dhe në raste të tjera, kur kërkohet nga Kryetari i Këshillit Drejtues, 1/3 e anëtarëve të Këshillit, apo nga Drejtori Ekzekutivi i AKBN. Ministri ka të drejtë të thërrasë mbledhjen e Këshillit Drejtues, kurdoherë, që e vlerëson të nevojshme.
4. Këshilli Drejtues, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh Sekretarin e Këshillit.
5. Të gjithë anëtarët duhet të informohen me shkrim, jo më pak se 5 (pesë) ditë para mbledhjes, për problemet që do të diskutohen dhe duhet t'u vihen në dispozicion materialet paraprake.
6. Mbledhjet e Këshillit Drejtues drejtohen nga Kryetari i Këshillit dhe në mungesë të tij, nga një anëtar i autorizuar prej tij.
7. Çdo anëtar, i pranishëm në mbledhjen e Këshillit Drejtues, ka të drejtën e një vote. Vendimet e Këshillit Drejtues merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm. Kur numri i votave është i barabartë, vota e Kryetarit është vendimtare.
8. Mbledhjet e Këshillit Drejtues dokumentohen me proces-verbal, i cili mbahet nga Sekretari i këtij Këshilli dhe firmoset nga ky i fundit dhe të gjithë anëtarët e pranishëm.
9. Vendimet e Këshillit Drejtues firmosen nga Kryetari i këtij Këshilli.
10. Në mbledhjet e Këshillit Drejtues mund të thirren, për të marrë pjesë, me kërkesë të Kryetarit ose anëtarëve, edhe punonjës të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, ose ekspertë të jashtëm, të cilët nuk kanë të drejtë vote.

Neni 10

Kompetencat e Këshillit Drejtues

1. Aprovon planin vjetor të punës së AKBN.
2. Mbikëqyr dhe vlerëson, te gjithë punën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, në mënyrë periodike dhe informon Ministrin.
3. Merr ne shqyrtim programin ekonomik dhe financiar te institucionit dhe ia paraqet për miratim Ministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe analizon periodikisht zbatimin e treguesve te këtij programi.
4. Propozon ndryshime, në lidhje me strukturën organizative të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, të cilat, nëpërmjet Kryetarit, i paraqiten Ministrin.
5. Shqyrton dhe propozon nevojën për ndryshim të Statut-Rregullores së funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe ia paraqet për miratim Ministrin.
6. Informohet për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore në periudhen ndërmjet dy mbledhjeve.
7. Miraton dhe ka të drejtë të ndryshojë rregulloren/et e brendshme, kriteret dhe standardet për aspekte të veçanta të punës së Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.
8. Aprovon strukturën e pagave e shpërblimeve dhe ia paraqet ato, për miratim, Ministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Neni 11

Drejtori Ekzekutiv i AKBN

Drejtori Ekzekutivi i AKBN emërohet dhe lirohet nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Neni 12

Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv te AKBN

1. Organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e AKBN, nëpërmjet urdhrave dhe udhëzimeve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me këtë Statut-Rregullore, për përmbushjen e misionit, për të cilin është krijuar AKBN.
2. Bashkërendon punën e drejtorive të AKBN, për të siguruar veprimtari sa më efektive të saj.
3. Emëron, liron, apo shkarkon nga detyra punonjësit e AKBN, si dhe jep masa administrative për rastet e shkeljes së disiplinës dhe etikës në institucion, si dhe raste të tjera, të përcaktuara nga legjislacioni i punës.
4. Përfaqëson Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në marrëdhënie me të tretët, si dhe nënshkruan kontrata.
5. Drejtori Ekzekutiv i AKBN ka të drejtë, që brenda kompetencave të tij t'u japë, një ose disa punonjësve të Agjencisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh.

Statut-Rregullore e Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN)

6. Ka të drejtën dhe përgjegjësinë e administrimit të fondeve në bazë të buxhetit të aprovuar nga Këshilli Drejtues.
7. Kërkon, kur e sheh të nevojshme, ndihmën e specializuar nga konsulentë jashtë AKBN ose studio profesionale brenda dhe jashtë vendit.

Neni 12/1

Zv/Drejtori Ekzekutiv te AKBN

Zv. Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së, emërohet dhe lirohet nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së.

Neni 12/2

Kompetencat e Zv/Drejtorit Ekzekutiv te AKBN

- a. Zv. Drejtori Ekzekutiv ndihmon Drejtorin Ekzekutiv për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të tij. Zv. Drejtori Ekzekutiv raporton tek Drejtori Ekzekutiv për detyrat që i janë caktuar si dhe ato që i janë deleguar.
- b. Zv. Drejtori Ekzekutiv zëvendëson Drejtorin Ekzekutiv, në kuptim të nenit 34/1 të Kodit të Procedurës Administrative, me urdhër të Drejtorit Ekzekutiv.
- c. Zv. Drejtori Ekzekutiv bashkërendon punën në drejtimin e fushës së veprimtarisë të AKBN-së.
- d. Zv. Drejtori Ekzekutiv luan rol koordinues dhe bashkërendues për zgjidhjen e problemeve të veçanta që kërkojnë bashkëpunimin e dy ose më shumë drejtorive brenda AKBN.
- e. Zv. Drejtori Ekzekutiv në cilësinë e mbikëqyrjes në fushën e veprimtarisë së AKBN, mund të thërrasë në takime bashkërenduese drejtorët e drejtorive të AKBN.
- f. Zv. Drejtori Ekzekutiv informohet dhe ndjek periodikisht zbatimin e detyrave të secilës drejtori.

Neni 13

Këshilli Teknik

1. Keshilli Teknik eshte organ kolegjal, vendim-marres, i perhershem, qe kryesohet nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN, i krijuar per shqyrtimin e projekteve te shfrytezimit te burimeve natyrore.
2. Anetaret e Keshillit Teknik emerohen nga Drejtori Ekzekutiv i Agjencise Kombetare te Burimeve Natyrore.
3. Keshilli Teknik funksionon mbeshtetur ne Rregulloren e tij, qe miratohet nga Keshilli Drejtues.

Neni 13/1

Konsulentët e Jashtëm

AKBN për raste të veçanta kërkon asistencë të specializuar dhe mund të përzgjedhë vetë Konsulentë të Jashtëm për rastet e përjashtuara nga ligji i prokurimit publik, për shërbimet e kërkimit dhe të zhvillimit në fushat ku ushtron veprimtarinë e saj.

Përzgjedhja dhe Kontraktimi i konsulentëve të jashtëm do të bëhet mbi bazën e procedurës së përcaktuar në këtë Statut- rregullore.

Statut-Rregullore e Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN)

Drejtoritë e specializuara sipas nevojave që kanë duhet të depozitojnë në Drejtorinë e Administratës përshkrimin e punës dhe kriteret e përcaktuara sipas specifikave të hartimit të studimit apo hartimit të projekteve që do të realizohen nga konsulentët e jashtëm.

Drejtoria e Administratës shpall njoftimin në faqen e internetit të AKBN-së, ku do të përcaktojnë datën e hapjes dhe të pranimit të dokumentacionit të kandidatëve.

Njoftimi për kontraktimin e Konsulentëve të Jashtëm do të përmbajë:

- Tema e studimit apo e projektit
- Numri i konsulentëve,
- Pëshkrimi i detajuar i punës që do të kryej konsulenti
- Kriteret e përgjithshme
- Kriteret e veçanta
- Listën e dokumenteve që duhet paraqitur;
- Afatin dhe vendin e dorëzimit të dokumenteve.

Kandidatët do të vlerësohen nga “Komisioni i brendshëm”, i ngritur pranë AKBN-së, rast pas rasti, ku anëtare do të jenë Drejtori i Drejtorisë e cila ka bërë kërkesën për konsulentë, përfaqësues nga Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Shërbimeve Ligjore.

Komisioni për çdo konkurim do të vëndosë përpara vlerësimit të kandidatit, totalin e pikëve të vlerësimit të kandidatit të cilat ndahen përkatësisht për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, për jetëshkrimin, për eksperiencën, për trajnimet dhe për kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse për të cilën kërkohet konsulencia për bërjen e studimit apo të projektit.

Pas përzgjedhjes nga komisioni të kandidatit që ka pikët më të larta ftohet për të lidhur kontratën individuale sipas kontratës tip të miratuar me udhër nga nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së.

Në rast se kandidati fitues nuk paraqitet brënda afatit të përcaktuar, do të ftohet kandidati i cili është në rradhë të dytë.

Për përzgjedhjen e anëtarëve të Grupit të Oponencës Teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve në AKBN, ndiqet procedura e parashikuar në këtë nen.

Kandidatët e përzgjedhur nga komisioni, propozohen tek ministri i MIE-s për miratim, në zbatim të Rregullores, “Për funksionimin e grupit të Oponencës Teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me konçension në AKBN.

Neni 13/2

Grupi i Oponencës teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve

- Grupi për kryerjen e Oponencës Teknike të projekteve të ndërtimit të hidrocentraleve me konçension është strukturë e posaçme që krijohet në AKBN, me urdhër të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë në zbatim të pikës 3, të VKM nr. 547, datë 09.08.2006, ‘Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve natyrore’, të ndryshuar.

- Grupi i Oponencës Teknike kryen oponencë për studimet e fizibilitetit për çdo projekt propozim dhe për projektet e zbatimit të hidrocentraleve dhe centraleve të tjera prodhuese të energjisë elektrike, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi.
- Grupi i Oponencës Teknike kryesohet nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së, funksionon dhe organizohet në bazë të Rregullores e cila miratohet nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Neni 14

Struktura dhe Organika

Struktura dhe organika e AKBN miratohen nga Ministri dhe i bashkëngjiten Statut-Rregullores, si pjesë përbërëse të saj.

Neni 14/1

Shfuqizohet

Neni 14/2

Këshilltarët

Këshilltarët janë struktura këshillimore pranë Drejtorit Ekzekutiv në fushën e veprimtarisë së AKBN dhe kanë këto detyra:

- a. Asistojnë Drejtorin Ekzekutiv në shqyrtimin e çështjeve brenda kompetencave të tij.
- b. Kërkojnë me shkrim informacion nga drejtoritë e AKBN, për fushat që ato mbulojnë, me qëllim këshillimin e Drejtorit Ekzekutiv.
- c. Bashkëpunon me drejtoritë përkatëse në AKBN, për respektimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore që veprojnë në fushën minerare, hidrokarbure, burimeve të rinovueshme të energjisë dhe hidroenergjetike.
- d. Kryejnë çdo detyrë të ngarkuar nga Drejtori Ekzekutiv.
- e. Këshilltarët, emërohen dhe lirohen nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së.

Neni 15

Drejtoritë e AKBN-së

1. AKBN-ja është e organizuar mbi bazën e Drejtorive dhe Sektorëve, të cilat mbulojnë fusha dhe veprimtari të veçanta.
2. Në strukturën organizative të AKBN-së, në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit Ekzekutiv, janë 9 (nëntë) Drejtori, si më poshtë:
 - Drejtoria Minerare
 - Drejtoria Hidrokarbure
 - Drejtoria Proçedurave Hidrokarbure
 - Drejtoria Monitorimit të HEC-ve

- Drejtoria e Energjive të Rinovueshme
 - Drejtoria Ekonomike
 - Drejtoria e Shërbimeve Ligjore
 - Drejtoria e Administratës
 - Drejtoria e Zhvillimit Strategjik dhe Dëgjësave me Publikun
3. Drejtoritë e mësipërme, në varësi të fushës dhe detyrave specifike që mbulojnë, në strukturën e tyre do të jenë të organizuar në bazë të sektorëve, të cilët do të funksionojnë bazuar në detyrat e përcaktuara në këtë Statut-Rregullore dhe në Rregulloren e brendshme të AKBN-së.

Neni 16

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë Minerare

1. Konsulton, propozon dhe bashkëpunon, me strukturat përkatëse të Qeverisë, për hartimin e politikave të saj në fushën minerare;
2. Zbaton politikat e Qeverisë në fushën minerare;
3. Siguron, brenda fushës së veprimtarisë së vet, oponencën qeveritare për studimet dhe projektet në fushën minerare dhe postminerare;
4. Promovon burimet minerare, negocion marrëveshjet minerare dhe ndjek zbatimin e planit të zhvillimit të tyre;
5. Mbikqyr veprimtarinë minerare e postminerare dhe raporton për gjendjen aktuale;
6. Realizon monitorimin e zonave të shfrytëzuara, të rrezikut minerar dhe të mbylljes së veprimtarisë minerare;
7. Vlerëson shkallën e rrezikut minerar, efektet e mundëshme dhe propozon masat që duhet të merren për parandalimin e tyre;
8. Administron, ekskluzivisht, të gjithë të dhënat parësore, që lidhen me veprimtarinë minerare dhe postminerare.
9. Organizon grupe pune për kryerjen e Akt-verifikimeve në terren për të gjitha kërkesat e bëra nga subjektet private për leje të reja minerare dhe harton dokumentacionin për to.
10. Organizon azhurnimin periodik me sektorin e projekteve minerare dhe industriale në ministri të lejeve të reja të dhëna nga ministria.
11. Të japë një pasqyrë sa më të qartë të aktivitetit minerar në kompleksitetin e tij në secilin subjekt, zonë, bashki apo qark.
12. Gjendjen teknike të objektit, duke paraqitur edhe të dhëna statistikore si, nivelin e prodhimit apo tregues cilësorë, për secilin objekt ne veçanti.
13. Ecurinë e lejeve në mënyrë kronologjike. Perditesimin e te dhenave të subjekteve minerare qe lidhen me statusin e tyre.

Neni 16/1

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë Hidrokarbure

1. Ndjek dhe zbaton kërkesat e Ligjit 7746, datë 28.07.1993, "Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)", te ndryshuar, në fushën e kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në bashkëpunim me investitorët vendas apo të huaj;
2. Ne kuader te AKBN, konsulton, propozon dhe bashkëpunon, me strukturat përkatëse të Qeverisë, për hartimin e politikave të saj në fushën e hidrokarbureve;
3. Promovon dhe negocion Marrëveshjet e Hidrokarbureve me subjektet juridike vendas apo të huaj, për blloqet e kërkimit ose vendburimet ekzistuese, sipas legjislacionit në fuqi dhe ne rastin e shoqërisë Albpetrol Sh.A. edhe Licencë Marrëveshjet
4. Ndjek zbatimin e marrëveshjeve hidrokarbure, sipas legjislacionit në fuqi;
5. Auditon në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, shpenzimet e kryera nga shoqëritë e licensuara për kryerjen e operacioneve hidrokarbure;
6. Ndhmon kontraktore e Marrëveshjeve Hidrokarbure për dhënien e lejeve, licensave e autorizimeve në përputhje me legjislacionin ne fuqi per te mundesuar kryerjen e operacioneve hidrokarbure;
7. Monitoron zbatimin e planeve te zhvillimit dhe programeve te punes dhe buxheteve te kryera nga kompanitë e ndryshme që operojnë në kuadër të Licensave apo Marrëveshjeve Hidrokarbure të miratuara;
8. Monitoron kompanitë e ndryshme që operojnë në kuadër të Licensave apo Marrëveshjeve Hidrokarbure për respektimin e Ligjit të Mjedisit;
9. Administron, mirëmban, përdor e përpunon, sipas teknikave dhe standarteve ndërkombëtare, të dhënat primare të sektorit hidrokarbur, sipas qëllimeve të aktivitetit të tij, ne zbatim te ligjit 7746, datë 28.07.1993, "Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)", te ndryshuar.

Neni 17

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë së Procedurave Hidrokarbure.

1. Ndjek zbatimin e Procedurave për Përrjashtimet nga Detyrimet(Doganore - Tvsh), të kompanive që kryejnë operacione hidrokarbure në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të përjashtimit nga TVSH dhe detyrimeve doganore.
2. Shqyrton kontratat që Kontraktori/ët e Marrëveshjeve Hidrokarbure kanë lidhur me Kontraktorët e tyre dhe objektin e tyre lidhur me shërbimet dhe punimet e kryera nga kompanitë hidrokarbure dhe nënkontraktorët e tyre gjatë kryerjes së operacioneve në zbatim të marrëveshjeve hidrokarbure.

3. Administron gjithë dokumentacionin dhe gjithë praktikat e nevojshme për lëshimin e autorizimeve për përjashtimin nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja, ndaj kompanive që kryejnë operacione hidrokarbure .
4. Përpunon të dhëna dhe mban data base për të gjithë praktikat e administruara dhe lëshuara për përjashtimin nga detyrimet doganore dhe TVSH-ja.

Neni 18

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë të Hidroenergjetikës

1. Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë së Monitorimit të HEC-ve.
2. Konsulton, propozon dhe bashkëpunon, me strukturat përkatëse të Qeverisë, për hartimin e politikave të saj në fushën e hidroenergjetikës.
3. Drejtorja e Monitorimit të HEC-ve shërben si organ i specializuar për monitorimin e realizimit të investimit në impiantet gjeneruese që janë objekt koncentrimi ose jo, dhënia e ndihmës së specializuar strukturave përkatëse të Qeverisë në hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e Hidroenergjisë.
4. Siguron, brenda fushës së veprimtarisë së vet, oponencën qeveritare për studimet dhe projektet në fushën hidroenergjetike.
5. Mbikëqyr veprimtarinë hidroenergjetike.

Neni 18/1

Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë të Energjive të Rinovueshme

1. Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë së Energjive të Rinovueshme
2. Përgatitjen dhe monitorimin e strategjisë së energjisë.
3. Monitorimin dhe promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, si dhe propozon masa për rritjen e shfrytëzimit të energjisë në ciklin e saj.
4. Hartimin dhe publikimin e bilancit energjetik vjetor, në nivel kombëtar dhe rajonal, në përputhje me formatet e EUROSTAT-it dhe të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë.

Neni 18/2

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë Ekonomike

1. Administron veprimtarinë ekonomiko- financiare të AKBN-së, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Përgatit projekt- buxhetin e AKBN-së.
3. Përgatit analizën të ardhura - shpenzime dhe nxjerr rezultatin përfundimtar të AKBN-së.
4. Në bashkëpunim me Drejtorinë Hidrokarbure auditon kostot hidrokarbure për efekt të çertifikimit të situacionit të mbulimit të kostove të rikuperueshme.

5. Ndjek ecurinë e projekteve me financim buxhetor dhe jobuxhetor.

Neni 18/3

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore

1. Të mbështesë strukturat e specializuara për krijimin e infrastrukturës dhe burimet e domosdoshme që garantojnë funksionimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së AKBN-së, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, Statut-rregulloren e funksionimit të AKBN-së dhe Rregulloren e brendshme të AKBN-së;
2. Të mbështesë drejtoritë në AKBN me qëllim funksionimin dhe kryerjen e veprimtarisë së tyre në përputhje me dispozitat në fuqi që veprojnë në fushën e veprimtarisë minerare, postminerare, hidrokarbure, hidroenergjisë dhe të energjisë së rinovueshme.
3. Të japë opinione dhe konsulenca strukturave në AKBN, mbi përputhshmërinë ligjore gjatë hartimit të projektakteve nënligjore, udhëzime, urdhëra, rregullore, marrëveshje, kontrata etj;
4. Përfaqëson AKBN me autorizim të Drejtorit Ekzekutiv në instancat gjyqësore dhe administrative në nivele ndërinstitucionale.
5. Të realizojë procedurat e prokurimit në zbatim të dispozitave ligjore shqiptare për prokurimin publik dhe të hartojë dhe monitorojë kontratat me të tretët, duke siguruar transparence dhe barazi për të gjithë operatorët ekonomikë dhe palët kontraktore.

Neni 18/4

Objekti i Veprimtarisë së Drejtorisë së Administratës

1. Siguron dhe menaxhon shërbimet ndihmëse dhe administrative;
2. Rregullon dhe kujdeset për administrimin e Burimeve Njerëzore;
3. Bashkërendon punën për zhvillimin e strategjisë së planifikimit të Burimeve Njerëzore, dhe monitoron progresin dhe produktivitetin e punonjësve të AKBN-së.
4. Sugjeron tek Drejtori Ekzekutiv ndryshime apo përmirësime në rregulloren e brendshme të AKBN-së, në lidhje me disiplinën dhe etikën e punonjësve.

Neni 19

Objekti i Veprimtarisë së Departamentit të Bashkërendimit

Shfuqizohet

Neni 19/1

Objekti i veprimtarisë së Drejtorisë të Energjisë Berthamore

Shfuqizohet

Neni 19/2

Drejtoria e Zhvillimit Strategjik dhe Dëgjësave me Publikun

1. Organizimi, koordinimi dhe drejtimi i punës për planifikimin e zhvillimit strategjik të AKBN-në.
2. Bashkërendimi i procesit të informimit të publikut nëpërmjet dëgjësave me publikun dhe marrëdhënieve me median.
3. Promovimi i punës së AKBN-së për burimet natyrore të energjisë në Shqipëri dhe përcjellja tek publiku i një imazhi pozitiv të punës së bërë.
4. Planifikimi i marrëdhënieve me jashtë të institucionit, organizimi i pjesëmarrjes në konferenca, panairë e aktivitete të tjera brenda dhe jashtë vendit.
5. Ndjekja e korrespondencës me agjensitë homologe, organizmat ndërkombëtare, misionet e tyre dhe përfaqësitë diplomatike të akreditura në Shqipëri, institucionet ndërkombëtare dhe investitorë të huaj, të interesuar për investime dhe nxit interesin e tyre për bashkëpunim me AKBN.

Neni 19/3

Struktura e pagave

“Drejtori Ekzekutiv për efekt të pagës, klasifikohet në të njëjtin nivel me sekretarin e përgjithshëm të ministrisë së linjës.

Pagat e punonjësve të tjerë referuar pagës së Drejtorit Ekzekutiv do të jenë në raportet e mëposhtme:

1.	Zv-Drejtor Ekzekutiv-----	0.94
2.	Këshilltarë-----	0.93
3.	Drejtor Drejtorie-----	0.93
4.	Shef Sektori-----	0.80
5.	Specialist i parë-----	0.65
6.	Specialist-----	0.55
7.	Sekretare e Dr. Ekzekutiv-----	0.45
8.	Magaznier-----	0.35
9.	Mirëmbajtës-----	0.35
10.	Punonjës informacioni-----	0.35
11.	Shofer-----	0.40
12.	Pastruese-----	0.30

Neni 20#

Planifikimi dhe Buxheti

“Për të gjithë veprimtarinë e saj ekonomike-financiare, AKBN përgatit programin ekonomik(buxhetin) dhe programin e zhvillimit për çdo vit kalendarik. Për projektet e financuara nga buxheti i shtetit, AKBN operon në përputhje me udhëzimin vjetor të MIE-es, për këtë qëllim”.

Neni 21#

Kontabiliteti

Veprimtaria ekonomiko-financiare e AKBN-së, pasqyrohet konform ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim.

Neni 22#

Burimet Financiare

Fondet e AKBN-së do të krijohen nga:

- Projektet dhe shërbimet për të tretët;
- Administrimi i të dhënave;
- Bonuset dhe fondet, kualifikim-administrim, nga marrëveshjet hidrokarbure;
- Shitja e pjesës së shtetit në një marrëveshje hidrokarbure;
- Projektet e financuara nga buxheti i shtetit;
- Interesat bankare;
- Donacione;
- Burime të tjera të ligjshme.

Neni 23

Fonde Monetare

Të gjitha shumat monetare, në monedhë vendase dhe të huaj, të trashëguara para krijimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, me V.K.M. Nr. 547, datë 09.08.2006, të krijuara pas kësaj date e në vazhdim, janë të mbartëshme nga njeri vit kalendarik ne tjetrin, me perjashtim te fondeve te financuara nga buxheti I shtetit, qe mbyllen Brenda vitit kalendarik.

Perdorimi i fondeve monetare, disponibel, behet vetem per permbushjen e detyrave te percaktuara ne aktin per krijimin e saj. Perdorimi i burimeve financiare, sit e ardhurat nga te tretet, do te behet mbi bazen e akteve ligjore e nenligjore ne fuqi.

Neni 24#

Marrëdhëniet e Punës

Marrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i Punës, me ndryshimet përkatëse.

“Procedurat për punësimin, emerimin dhe lirimimin e punonjësve të AKBN-së, do të bëhen sipas kritereve të përcaktuara në Rregulloren e brendëshme të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”.

Neni 25

Rregullat e Etikës

Në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore do të zbatohen rregullat e etikës, të miratuara në ligjin “Për etikën në administratën publike”.

Neni 26

Masat Disiplinore

1. Në rastet e shkeljes së disiplinës në punë, konstatimit dhe/ose të verifikimit të veprimeve, apo mosveprimeve që cenojnë figurën e etikës të punonjësve, moskërkim të urdherave të punëdhënësit, moskryerje të detyrave të ngarkuara dhe mosrespektim të perseritur të afateve të caktuara për realizimin e tyre, për çdo demtim të pasurisë së AKBN, përdorimin e saj jashtë përcaktimit zyrtar, keqpërdorimin e saj apo për krijimin e mundësive për lejimin e një demtimi të ardhshëm nëpërmjet veprimit ose mosveprimit, për nxjerrjen e sekretit të përfituar nga ushtrimi i detyrave të tij funksionale, ndaj punonjësve të AKBN-së, merren këto masa disiplinore:

- a. Terheqje vëmendje
 - b. Verejtje me shkrim
 - c. Verejtje me paralajmërim për largim nga puna
 - d. ulje në detyrë deri në 1 vit
 - e. Largim nga puna
2. Masat disiplinore mund të merren edhe pa i respektuar rradhët e mesipërme sipas demtit ose shkeljes që shkaktohet rast pas rasti.
3. Afati i parashkrimit për masat disiplinore, përcaktohet në dispozitat ligjore në fuqi.
4. Masat disiplinore i jepen punonjësve të AKBN-së nga Drejtori Ekzekutiv i AKBN-së, me motivin përkatës, të shprehur qartë dhe në prani të tij.

Neni 27

Marrëdhëniet e AKBN me Ministrin

Drejtori Ekzekutiv i AKBN siguron zbatimin e detyrave që i ngarkohen asaj nga Ministri dhe përgjigjet për realizimin e tyre.

Statut-Rregullore e Funkcionimit të Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN)

Ai organizon raportimin periodik tek ministri, te veprimtarise tekniko-shkencore dhe ekonomise-financiare te AKBN.

Neni 28

Administrimi i Informacionit

Klasifikimi i dokumentacionit dhe ruajtja e tij, bëhet sipas legjislacionit në fuqi, metodologjisë së përpunimit të dokumentacionit dhe ruajtjes së tij.

Neni 29

Miratimi i Statut – Rregullores

Kjo Statut - Rregullore merr fuqi dhe bëhet e detyrueshme për zbatim, menjëherë, me miratimin e saj prej Ministrisë. Me miratimin e saj shfuqizohet Statut – Rregullorja e mëparshme.